



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
OSNOVNI SUD UROŠEVAC – BASIC COURT OF FERIZAJ

---

**Raporti i rregullt i punës**  
**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**Janar – Dhjetor 2022**

**RAPORTI I RREGULLT I PUNËS SË GJYKATËS THEMELORE NË FERIZAJ**

**(Periudha 1 janar deri me 31 dhjetor 2022)**

Bazuar në nenin 14 paragrafi 2 pika 2.4 të Ligjit për Gjykatat, Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj, paraqet raportin e rregullt të punës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2022.

Gjykata Themelore në Ferizaj dhjetor të vitit 2021 ka hartuar planin e punës së gjykatës për vitin 2022, i cili plan vjetor i punës është aprovuar në kolegiumin e gjyqtarëve të Gjykatës Themelore dhe degëve të saj të mbajtur me datë 15 dhjetor 2021, në kuadër të cilit planit të punës për vitin 2022 është edhe programi për zgjidhjen efikase të lëndëve, i cili plan i punës dhe program ka për qëllim të adresimit më efikas dhe në funksion të trajtimit dhe zgjidhjes sa më shpejt dhe në kohë të justifikueshme të çështjeve gjyqësore.

Gjykata Themelore në Ferizaj me degët e sajë në Kaçanik dhe Shtërpcë, përmes këtij rapporti prezanton në mënyrë përbledhëse punën e gjykatës për vitin 2022 (janar – dhjetor), duke prezantuar njëkohësisht të arriturat, sfidat gjatë kësaj periudhe raportuese, si në aspektin profesional ashtu edhe në atë administrativ, me qëllim të paraqitjes së volumit të punës së kryer në formë statistikore, tabelore dhe diagrameve në vazhdim.

Aktualisht Gjykata Themelore në Ferizaj me degët në Kaçanik dhe Shtërpcë ka të angazhuar gjithsejtë njëzet e nëntë (29) gjyqtar duke përfshirë edhe kryetarin e gjykatës. Po ashtu tre prej tyre janë dekretuar gjyqtar me datë 12.07.2022 dhe momentalisht janë duke e ndjekur trajnimin fillestare për gjyqtar në Akademinë e Drejtësisë. Ndërsa numri total i të punësuarve në Administratën e Gjykatës Themelore në Ferizaj dhe degët e sajë në Kaçanik dhe Shtërpcë është 135 persona përfshirë Administratorin e gjykatës dhe dy ndihmës administrator (86 të punësuar në Gjykatën Themelore në Ferizaj, 24 në degën e gjykatës në Kaçanik dhe 25 në degën e gjykatës në Shtërpcë).

Gjatë kësaj periudhe të vitit 2022 dy gjyqtar të kësaj gjykate janë avancuar në Gjykatën e Apelit të Kosovës, njëri në muajin shkurt 2022 dhe tjetri në muajin korrik 2022.

Në aspektin finansiar, gjatë periudhës raportuese, ekipi finansiar ka qenë i konsoliduar dhe ka arritur ti përfundoj me sukses detyrat që kanë të bëjnë me çështjet financiare. Në këtë periudhë raportuese (janar - dhjetor 2022), zyra e financave ka realizuar: të hyra gjyqësore të cilat janë derdhur në Buxhetin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës e që kanë qenë 994,947.08 €, prej tyre 689,404.00€ janë të hyra nga gjobat, si dhe 305,543.08 € pagesa nga taksat dhe paushallët gjyqësore, ndërsa shpenzime buxhetore për nevojat e gjykatës gjatë periudhë vjetore të vitit 2022 kanë qenë 172364,23 €, të shpenzuar përmallra dhe shërbime, ndërsa 39,996.79 € për shpenzime komunale.

Gjykata për periudhën raportuese, në kuadër të Udhëzimit Administrativ (02/2016) për Anonimizimin dhe Publikimin e Aktgjykimeve, ka vazhduar publikimin e aktgjykimeve të anonymizuara dhe për këtë periudhë janë publikuar rreth 704 aktgjykime.

Web Portali i gjyqësorit edhe për këtë periudhë ka shërbyer si urë lidhëse ndërmjet publikut dhe gjykatës kjo me qëllim të informimit të publikut rreth aktiviteteve, orarit të seancave gjyqësore, vendimeve dhe të tjera, ndërsa përmes rrjetit social facebook publikut i është mundësuar qasje e lehtë në punën e gjykatës. Përveç këtyre shërbimeve të cilat ofrohen në portalin gjyqësor dhe rrjetet sociale, si shërbime shtesë të cilat dëshmojnë transparencën e gjyqësorit karshi publikut, në hyrje të gjykatës janë të vendosur tre monitorë të cilët pasqyrojnë kalendarin me orarin e seancave gjyqësore si dhe tabela orientuese, këto si në Gjykatën Themelore në Ferizaj ashtu edhe në degët e sajë në Kaçanik dhe Shtërpcë.

Gjatë periudhës raportuese Gjykata Themelore në Ferizaj në janar të vitit 2022 ka filluar projektin për regjistrimin dhe asgjësimin e lëndëve kundërvajtëse të cilat kanë plotësuar kushtet ligjore për asgjësim. Në kuadër të këtij procesi, KGJK në bashkëpunim me UNDP-në, e ka mbështetur Gjykatën tonë në këtë proces me zyrtar ligjor ku aktualisht janë dy zyrtarë ligjorë të angazhuar e të cilët merren me regjistrimin e lëndëve kundërvajtëse të cilat i plotësojnë kushtet për asgjësim dhe për periudhën janar - dhjetor 2022 kanë arritur të regjistrojnë gjithsej 90930 lëndë.

Në Gjykatën Themelore në Ferizaj – dega në Kaçanik janë të regjistruar gjithsej 67295 lëndë dhe tani procesi është në fazën e skanimit të vendimit përfundimtar. Po ashtu Gjykatën Themelore në Ferizaj – dega në Shtërpcë janë regjistruar gjithsej 6180 lëndë.

Gjithashtu Gjykata Themelore në Ferizaj e përkrahur nga USAID në Projektin për Drejtësi fillimisht e përzgjedhur si gjykatë model ka filluar Pilot Projektin për Drejtësi Procedurale i cili projekt ka për qëllim përmirësimin e cilësisë dhe qasjes në shërbimet të cilat ofrohen nga gjykata, e që ky projekt tani është në fazën e implementimit sipas planit të veprimit aprovuar nga grupi punues i gjykatës, e i cili plan është i aprovuar në Asamblenë e Kryetarëve të Gjykatave. Gjatë kësaj periudhe të implementimit të këtij projekti në bashkëpunim me USAID, në hapsirat e katit përdhese të gjykatës me qëllim të ofrimit të shërbimeve dhe qasjes për personat e verbër në hapësirat e katit përdhese është vendosur shtegu për lëvizje për këta persona i lehtëson dhe mundëson çasje në sportelin e informacionit dhe sportelet e shkrimoreve të gjykatës për këtë kategori të personave, si dhe në oborrin e gjykatës është bërë shenjëzimi i vend parkingjeve për persona me aftësi të kufizuara.

Gjykata Themelore në Ferizaj ka vazhduar me implementimin e Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (TIK/SMIL), i cili ka treguar sukses dhe rritjen e efikasitetit dhe transparencës së gjykatës. Në periudhën raportuese të gjitha raportet e të gjithë gjyqtarëve janë nxjerr vetëm përmes sistemit SMIL, përfshirë këtu edhe raportet e përgjithshme të gjykatës, të gjitha lëndët pranohen në gjykatë përmes SMIL-it, po ashtu orari i seancave gjyqësore për publikim në ueb faqen e gjyqësorit është i lidhur direkt me SMIL dhe të dhënat publikohen në ueb faqe. Po ashtu gjatë periudhës raportuese sipas vendimit të KGJK-së, nga data 1 shkurt e sipas udhëzimeve të zyrtarëve të departamentit të IT-së në SKGJK, gjykata ka filluar me procedimin e ankesave në lëmin penale gjatë procedurës paraprake në mes të gjykatave Themelore dhe Gjykatës se Apelit përmes Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL) dhe procedimin e ankesave përmes SMIL-it në Gjykatën e Apelit.

Gjatë kësaj periudhe gjykata ka vazhduar bashkëpunimin me institucione, veprimtaria e të cilave mundë të ketë ndikim në aspektin e efikasitetit apo të ngritjes së besueshmërisë së opinionit publik përgjithësi në gjykatë ka vazhduar të shfaqë efekte pozitive si në zbatimin e urdhëresave të lëshuara nga gjykata, ashtu edhe me zbatimin e vendimeve nga ana e institucioneve si vendore po ashtu edhe

ndërkombëtare, siç janë: Policisë së Kosovës, Prokurorisë Themelore, Qendrës për Punë Sociale zyra rajonale, Shërbimi Korrektues i Kosovës, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, USAID, OSCE etj. Bashkëpunimi me Prokurorinë Themelore në Ferizaj është i vazhdueshëm, po aq sa edhe me Policinë Rajonale të Ferizajt. Për këtë periudhë po ashtu janë zhvilluar takime me përfaqësues të Qendrës për Punë Sociale, OJQ-ve, PTK-së dhe monitorues të sistemit të Drejtësisë.

Bazuar në planin vjetor të punës së Gjykatës Themelore në Ferizaj për vitin 2022, si dhe planit të veprimit për zgjidhjen e lëndëve të korruptionit, Gjykata Themelore e Ferizajt, me prioritet ka shqyrta edhe zgjidhjen e lëndëve me natyrë korruptive, në mënyrë që të njëjtat të përfundohen brenda periudhave sa më të shkurta kohore.

Sipas të dhënave statistikore lëndë të trashëguara të natyrës së korruptionit nga viti 2021 në vitin 2022, kanë qenë shtatëmbëdhjetë (17), janë pranuar pesëmbëdhjetë (15) lëndë, të kryera në këtë periudhë janë dhjetë (18), ndërsa lëndë të pakryera janë katërbëdhjetë (14) lëndë.


Raportet statistikore sipas viteve pasqyrojnë, efikasitetin në kryerjen e lëndëve në Gjykatën Themelore në Ferizaj së bashku me degët e saj Kaçanik dhe Shtërpcë, përkatësisht krahasimet e viteve paraprake për lëndët e pranuara dhe lëndët e zgjidhura, përveç raporteve të paraqitura si më lartë në lëmine civile, ku në vitin 2022 ka vazhduar trendi i ardhjes numrit të lartë të kërkësave dhe padive kryesisht që kanë të bëjnë me kontratat kolektive nga mësimdhënësit, shëndetësia, Policia e Kosovës etj (paga jubilare, shujtat, licencimet), të cilat lëndë të kësaj natyre kanë ndikuar shumë në ngritjen e përqindjes së lëndëve në Gjykatë, e po ashtu kanë ndikuar në uljen e përqindjes së shkallës së spastrimit të lëndëve në përgjithësi.

Diagrami pasues pasqyron krahasimet ndër vite të lëndëve të pranuara dhe të zgjidhura dhe një pasqyrë krahasimore e efikasitetit të gjykatës ndër vite. Nga kjo tabele me diagrame vërehet se Gjykata Themelore në Ferizaj gjatë vitit 2013 ka pranuar 16.397 lëndë, gjatë vitit 2014 ka pranuar 36.398 lëndë, në vitin 2015 ka pranua 35.646 lëndë, në vitin 2016 ka pranuar 38.739 lëndë. Për periudhën e vitit 2017 gjykata ka pranuar 17.677 lëndë, gjatë vitit 2018 - 15.687, gjatë vitit 2019 janë pranuar 17.400 lëndë, gjatë vitit 2020 janë pranuar 12.306 lëndë, në periudhën e vitit 2021 janë

pranuar 14.841 lëndë, ndërsa në periudhën e vitit 2022 gjithsej janë pranuar 16,719 (lëndë prej të cilave 3197 të lëndëve janë të natyrës kundërvajtëse). Kjo rënie e lëndëve sipas këtyre statistikave ka të bëjë me lëndët kundërvajtës, ku dihet që me ligjin e ri të kundërvajtjes ka rënë dukshëm numri i këtyre lëndëve, megjithatë gjatë viteve 2020-2022 kemi një rritje enorme të lëndëve të natyrës civile dhe me paditë që kanë të bëjnë me kontratat kolektive të arsimit, shëndetësisë dhe policisë.



Lëndë të zgjidhura gjatë vitit 2013 kanë qenë 14.149 lëndë, gjatë vitit 2014 – 31.130 lëndë, gjatë vitit 2015 – 39.743, gjatë vitit 2016 – 41.095, për vitin 2017 janë zgjidhur gjithsejtë 39.758 lëndë, gjatë vitit 2018 janë zgjidhur 27.016 lëndë, në vitin 2019 janë zgjidhur 15.192 lëndë, gjatë vitit 2020 janë zgjidhur 10.773 lëndë, gjatë vitit 2021 janë zgjidhur 10.189 lëndë, ndërsa gjatë vitit 2022 janë të zgjidhura 12.863 lëndë.



### ***Efikasiteti i Gjykatës Themelore Ferizaj***

Gjendja aktuale tregon se kemi bilanc pozitiv në disa divizione në raport me lëndët e kryera dhe të pranuara, dhe në tabelën në vijim paraqiten të dhënat për secilin departament/divizion.

#### **Statistikat**

Gjatë periudhës së vitit 2022 Gjykata Themelore në Ferizaj së bashku me degët e saj në Kaçanik dhe Shtërpçë ka të evidentuara në punë 35755 lëndë (pa përfshirë lëndët kundërvajtëse), ndërsa kanë mbetur të pa përfunduara 25457 lëndë.

**Departamenti për Krime të Rënda** gjatë periudhës reportuese ka pranuar 185 lëndë, ka përfunduar 170 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pa përfunduara 238 lëndë. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë periudhë në DKR është 91,98 %.

**Departamenti për të Mitur** në periudhën reportuese ka pranuar 100 lëndë, ka përfunduar 103 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pa përfunduara 181 lëndë. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë periudhë është 103%.

Në **Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Penal** (së bashku me degë), në periudhën reportuese ka pranuar nga gjithsej 1694 lëndë, ka përfunduar gjithsej 1939 lëndë, ndërsa kanë

mbetur të pa përfunduara 3360 lëndë. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë periudhë është 11446 %.

Në Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Civil (së bashku me degë), gjatë periudhës raportuese pranuar gjithsej 4468 lëndë, ka përfunduar 2391 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pa përfunduara 8019. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë periudhë është 53,51 %. Kjo përqindje e ulët e normës së spastrimit është si rezultat i ardhjes së numrit të madhe të kërkesave civile, konkretisht lëndëve që kanë të bëjnë me kontratat kolektive të punonjësve të arsimit, shëndetësisë dhe policisë.

Në Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Kundërvajtës (së bashku me degë) gjatë këtij tremujori ka pranuar gjithsej 3197 lëndë, ka përfunduar 2565 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pa përfunduara 4750 lëndë. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë periudhë është 80.23 %.

### Gjykata Themelore në Ferizaj me Degë

*Në vazhdim tabela 1 përmban të dhënrat për lëndët e trashëguara, të pranuara, në punë, të kryera dhe lëndët e pa kryera për periudhën e vitit 2022 ( 1 janar deri më 31 dhjetor 2022) për Gjykatën Themelore në Ferizaj me degë)*

**Tabela 1**

Gjykata Themelore Ferizaj -Bashk me degë						
Raporti vjetor 2022 -Me SMIL	Lëndët të trashëgura	Lëndë të pranuara-2022	Gjithësejt lëndë në punë	Lëndë të kryera	Gjithësejt lëndë të pa kryera	Efikasiteti gjykatës (lëndët e zgjedhura dhe lëndët e pranuara x 100)
Lloji i lëndëve						
Procedura Paraprake - DP	519	264	783	215	568	81.44
Penale shkalla e parë- DP	3605	1694	5299	1939	3360	114.46
Procedurë Paraprake - DKR	186	184	370	132	238	71.74
Penale shkalla e parë - DKR	319	185	504	170	334	91.89
Penale për të mitur në proc.përgaditore	31	36	67	32	35	88.89
Penale për të mitur në proc.Para Kolegjit	184	100	284	103	181	103.00
Civile të shkallës së I-rë	5942	4468	10410	2391	8019	53.51
Jashtëkontestimore	693	270	963	279	684	103.33
Përbmarimore	2496	2659	5155	1917	3238	72.09
Përmbarime sipas dokumenteve autentike	2121	0	2121	130	1991	#DIV/0!
Përmbarime sipas dokumentit përmbarues	757	795	1552	748	804	94.09
Ekz.Paushalla dhe shpenzime gjyqësore	3512	1478	4990	731	4259	49.46
Ekz.civile PPP	402	304	706	340	366	111.84
Ekz.Penale me burg	133	222	355	151	204	68.02
Ekz. Penale me gjoblë- EDGJ	1332	857	2189	1013	1176	118.20
Ekz.i masave edukative për të mitur	1	6	7	7	0	116.67
UGJK	0	0	0	0	0	#DIV/0!
<b>GJITHËSEJT</b>	<b>22233</b>	<b>13522</b>	<b>35755</b>	<b>10298</b>	<b>25457</b>	<b>76.16</b>
Lëndët tjera: certifikata, v.apostile, etj	0	0	0	0	0	#DIV/0!
<b>Lëmia Kundërvajtëse</b>	<b>Lëndët të trashëgura</b>	<b>Lëndë të pranuara-2022</b>	<b>Gjithësejt lëndë në punë</b>	<b>Lëndë të kryera</b>	<b>Gjithësejt lëndë të pa kryera</b>	<b>Efikasiteti gjykatës (lëndët e zgjedhura dhe lëndët e pranuara x 100 )</b>
<b>Lëmia- Kundërvajtëse</b>	<b>4118</b>	<b>3197</b>	<b>7315</b>	<b>2565</b>	<b>4750</b>	<b>80.23</b>
<b>GJITHËSEJT</b>	<b>4118</b>	<b>3197</b>	<b>7315</b>	<b>2565</b>	<b>4750</b>	

## Gjykata Themelore në Ferizaj

**Gjykata gjatë vitit 2022,** ka të evidentuara në punë 27079 lëndë (me përjashtim të lëndëve kundërvajtëse), 161318 të trashëgura nga viti paraprak, gjatë vitit 2022 janë pranuar 10761 lëndëm prej tyre janë përfunduar 7335, ndërsa trashëgohen në vitin 2023 si të pa përfunduara 19744 lëndë. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë vit është afër 68.16 %.

**Departamenti për Krime të Rënda**, gjatë vitit 2022 ka pranuar 185 lëndë, ka përfunduar 170, ndërsa kanë mbetur të pa përfunduara 334 lëndë Norma e spastrimit të lëndëve për këtë vit në DKR është 91.89 %.

**Departamenti për të Mitur**, ka pranuar 100 lëndë, ka zgjidhur 103 lëndë, ndërsa kanë mbetur në punë 181 lëndë. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë vit në këtë Departament është 103 %.

**Departamenti i Përgjithshëm përkatesisht Divizioni Penal** nga gjithsej 3593 lëndë sa ka pasur në punë, prej tyre lëndë të pranuara gjatë vitit 2022 janë 1224 lëndë, të zgjidhura 1331, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 2262. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë vit në DP është 108.74 %.

**Divizioni Civil**, nga gjithsej 8105 lëndë sa ka pasur në punë, prej tyre lëndë të pranuara gjatë vitit 2022 janë pranuar 3729, ndërsa janë të zgjidhura 1838, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 6267. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë vit në Divisionin civil është 49,29 %.

**Divizioni për Kundërvajtje** i Gjykatës Themelore në Ferizaj së bashku me degët Kaçanik dhe Shtërpcë ka të evidentuara 7315 prej tyre janë përfunduar 2565 ndërsa barten në vitin 2022, 4750 lëndë, norma e zgjidhjes së këtyre lëndëve është 80.23 %.

*Në vazhdim tabela 2 përmban të dhënrat për lëndët e trashëguara, të pranuara, në punë, të kryera dhe lëndët e pa kryera për periudhën e vitit 2022 ( 1 janar deri më 31 dhjetor 2022) për Gjykatën Themelore në Ferizaj*

**Tabela 2**

Lloji i lëndëve	Lëndët të trashëgura	Lëndë të pranuara-2022	Gjithësejt lëndë në punë	Lëndë të kryera	Gjithësejt lëndë të pa kryera	Efikasiteti gjykatës (lëndët e zgjidhura dhe lëndët e pranuara x 100)
Procedura Paraprake - DP	389	187	576	155	421	82.89
Penale shkalla e parë - DP	2369	1224	3593	1331	2262	108.74
Procedurë Paraprake - DKR	186	184	370	132	238	71.74
Penale shkalla e parë - DKR	319	185	504	170	334	91.89
Penale për të mitur në proc.përgaditore	31	36	67	32	35	88.89
Penale për të mitur në proc.Para Kolegjit	184	100	284	103	181	103.00
Civile të shkallës së I-rë	4376	3729	8105	1838	6267	49.29
Jashtëkontestimore	282	205	487	192	295	93.66
Përmbarimore	1892	2038	3930	970	2960	47.60
Përmbarime sipas dokumenteve autentike	1478	0	1478	129	1349	#DIV/0!
Përmbarime sipas dokumentit përmbarues	691	795	1486	748	738	94.09
Ekz.Pausballa dhe shpenzime gjyqësore	2687	999	3686	377	3309	37.74
Ekz.civile PPP	265	241	506	278	228	115.35
Ekz.Penale me burg	112	190	302	133	169	70.00
Ekz. Penale me gjobë- EDGJ	1056	642	1698	740	958	115.26
Ekz.i masave edukative për të mitur	1	6	7	7	0	116.67
UGJK			0		0	#DIV/0!
<b>GJITHËSEJT</b>	<b>16318</b>	<b>10761</b>	<b>27079</b>	<b>7335</b>	<b>19744</b>	<b>68.16</b>
Lëndët tjera: certifikata, apostile, etj	0		0		0	#DIV/0!
<b>Lëmia Kundërvajtëse</b>	<b>Lëndët të trashëgura</b>	<b>Lëndë të pranuara-2022</b>	<b>Gjithësejt lëndë në punë</b>	<b>Lëndë të kryera</b>	<b>Gjithësejt lëndë të pa kryera</b>	<b>Efikasiteti gjykatës (lëndët e zgjidhura dhe lëndët e pranuara x 100 )</b>
Lëmia- Kundërvajtëse	3321	2365	5686	2038	3648	86.17
<b>GJITHËSEJT</b>	<b>3321</b>	<b>2365</b>	<b>5686</b>	<b>2038</b>	<b>3648</b>	

## Gjykata Themelore në Ferizaj - Dega së Gjykatës në Kaçanik

**Gjykata Themelore në Ferizaj dega në Kaçanik gjatë vitit 2022**, ka të evidentuara në punë 7023 lëndë (me përjashtim të lëndëve kundërvajtëse), prej tyre janë përfunduar 2350, ndërsa trashëgohen në vitin 2023 si të pa përfunduara 4673 lëndë. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë vit është afër 113.53 %.

**Departamenti i Përgjithshëm përkatisisht Divizioni Penal** nga gjithsej 1306 lëndë sa ka pasur në punë, prej tyre lëndë të pranuara gjatë vitit 2022 janë 362 lëndë, të zgjidhura 417, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 3360. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë vit në DP është 115.19 %.

**Divizioni Civil**, nga gjithsej 1714 lëndë sa ka pasur në punë, prej tyre lëndë të pranuara gjatë vitit 2022 janë 491 lëndë, të zgjidhura 353, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 1361. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë vit në Divisionin civil është 71.89 %.

**Divizioni për Kundërvajtje** ka të evidentuara 1389 prej tyre janë përfunduar 434, ndërsa barten në vitin 2023 4750 lëndë, norma e zgjidhjes së këtyre lëndëve është 60.53 %.

*Në vazhdim tabela 3 përmban të dhënat për lëndët e trashëguara, të pranuara, në punë, të kryera dhe lëndët e pa kryera për periudhën e vitit 2022 ( 1 janar deri më 31 dhjetor 2022) për Gjykatën Themelore në Ferizaj - dega në Kaçanik)*

**Tabela 3**

Lloji i lëndëve	Lëndët të trashëguara	Lëndë të pranuara-2022	Gjithësejt lëndë në punë	Lëndë të kryera	Gjithësejt lëndë të pa kryera	Efikasiteti gjykatës (lëndët e zgjidhura dhe lëndët e pranuara x 100)
Procedura Paraprake - DP	85	65	150	48	102	73.85
Penale shkalla e parë- DP	944	362	1306	417	889	115.19
Procedurë Paraprake - DKR	0	0	0	0	0	#DIV/0!
Penale shkalla e parë - DKR	0	0	0	0	0	#DIV/0!
Penale për të mitur në proc.përgaditore	0	0	0	0	0	#DIV/0!
Penale për të mitur në proc.Para Kolegit	0	0	0	0	0	#DIV/0!
Civile të shkallës së I-rë	1223	491	1714	353	1361	71.89
Jashëtë kontestimore	388	46	434	70	364	152.17
Përbartimore	499	434	933	847	86	195.16
Përbartime sipas dokumenteve autentike	627	0	627	1	626	#DIV/0!
Përbartime sipas dokumentit përbartues	49	0	49	0	49	#DIV/0!
Ekz.Paushalla dhe shpenzime gjyqësore	720	375	1095	278	817	74.13
Ekz.civile PPP	137	63	200	62	138	98.41
Ekz.Penale me burg	21	32	53	18	35	56.25
Ekz. Penale me gjobë- EDGJ	260	202	462	256	206	126.73
Ekz.i masave edukative për të mitur	0	0	0	0	0	#DIV/0!
UGJK	0	0	0	0	0	#DIV/0!
<b>GJITHËSEJT</b>	<b>4953</b>	<b>2070</b>	<b>7023</b>	<b>2350</b>	<b>4673</b>	<b>113.53</b>
Lëndët tjera: certifikata, v.apostille, etj	0	0	0	0	0	#DIV/0!
<hr/>						
Lëmia Kundërvajtëse	Lëndët të trashëguara	Lëndë të pranuara-2022	Gjithësejt lëndë në punë	Lëndë të kryera	Gjithësejt lëndë të pa kryera	Efikasiteti gjykatës (lëndët e zgjidhura dhe lëndët e pranuara x 100 )
Lëmia- Kundërvajtëse	672	717	1389	434	955	60.53
<b>GJITHËSEJT</b>	<b>672</b>	<b>717</b>	<b>1389</b>	<b>434</b>	<b>955</b>	

## **Gjykata Themelore në Ferizaj - Dega e Gjykatës në Shtërpë**

**Gjykata Themelore Ferizaj – dega Kaçanik gjatë vitit 2022**, ka të evidentuara në punë 1653 lëndë (me përjashtim të lëndëve kundërvajtëse), prej tyre janë përfunduar 613, ndërsa trashëgohen në vitin 2023 si të pa përfunduara 1040 lëndë. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë vit është 88,70 %.

**Departamenti i Përgjithshëm përkatesisht Divizioni Penal** nga gjithsej 400 lëndë sa ka pasur në punë, prej tyre lëndë të pranuara gjatë vitit 2022 janë 108 lëndë, të zgjidhura 191, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 209. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë vit në DP është 176,85 %.

**Divizioni Civil**, nga gjithsej 591 lëndë sa ka pasur në punë, prej tyre lëndë të pranuara gjatë vitit 2022 janë 248 lëndë, të zgjidhura 200, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 391. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë vit në Divisionin civil është 80,65 %.

**Divizioni për Kundërvajtje** ka të evidentuara 240 prej tyre janë përfunduar 93 ndërsa barten në vitin 2022, 147 lëndë, norma e zgjidhjes së këtyre lëndëve është 80,87 %.

Në vazhdim tabela 4 përmban të dhënat për lëndët e trashëgura, të pranuara, në punë, të kryera dhe lëndët e pa kryera për periudhën e vitit 2022 ( 1 janar deri më 31 dhjetor 2022) për Gjykatën Themelore në Ferizaj - dega në Shtërpçë)

**Tabela 4**

Lloji i lëndëve	Lëndët të trashëgura	Lëndë të pranuara-2022	Gjithësejt lëndë në punë	Lëndë të kryera	Gjithësejt lëndë të pa kryera	Efikasiteti gjykatës (lëndët e zgjidhura dhe lëndët e pranuara x 100)
Procedura Paraprake - DP	45	12	57	12	45	100.00
Penale shkalla e parë- DP	292	108	400	191	209	176.85
Procedurë Paraprake - DKR	0	0	0	0	0	#DIV/0!
Penale shkalla e parë - DKR	0	0	0	0	0	#DIV/0!
Penale për të mitur në proc.përgaditore	0	0	0	0	0	#DIV/0!
Penale për të mitur në proc.Para Kolegjit	0	0	0	0	0	#DIV/0!
Civile të shkallës së I-rë	343	248	591	200	391	80.65
Jashtëkontestimore	23	19	42	17	25	89.47
Përbartimore	105	187	292	100	192	53.48
Përbartime sipas dokumenteve autentike	16	0	16	0	16	#DIV/0!
Përbartime sipas dokumentit përbartues	17	0	17	0	17	#DIV/0!
Ekz.Paushalla dhe shpenzime gjyqësore	105	104	209	76	133	73.08
Ekz.civile PPP			0		0	#DIV/0!
Ekz.Penale me burg	0	0	0	0	0	#DIV/0!
Ekz. Penale me gjobë- EDGJ	16	13	29	17	12	130.77
Ekzi masave edukative për të mitur	0	0	0	0	0	#DIV/0!
UGJK	0	0	0	0	0	#DIV/0!
<b>GJITHËSEJT</b>	<b>962</b>	<b>691</b>	<b>1653</b>	<b>613</b>	<b>1040</b>	<b>88.71</b>
Lëndët tjera: certifikata, v.apostile, etj	0	0	0	0	0	#DIV/0!
<b>Lëmia Kundërvajtëse</b>	<b>Lëndët të trashëgura</b>	<b>Lëndë të pranuara-2022</b>	<b>Gjithësejt lëndë në punë</b>	<b>Lëndë të kryera</b>	<b>Gjithësejt lëndë të pa kryera</b>	<b>Efikasiteti gjykatës (lëndët e zgjidhura dhe lëndët e pranuara x 100 )</b>
<b>Lëmia- Kundërvajtëse</b>	<b>125</b>	<b>115</b>	<b>240</b>	<b>93</b>	<b>147</b>	<b>80.87</b>
<b>GJITHËSEJT</b>	<b>125</b>	<b>115</b>	<b>240</b>	<b>93</b>	<b>147</b>	

### Zyra e Kryetarit

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2022, Kryetari i Gjykatës ka zhvilluar takime të rregullta dhe mbledhje të kolegjiumit me gjyqtarë të gjykatës, janë mbajtur takime të rregullta me udhëheqës të departamenteve të gjykatës dhe me degët e gjykatës në Shtërpçë dhe në Kaçanik, ku është diskutuar lidhur me menaxhimin sa më efikas të gjykatës, organizimin e punës në Gjykatë, funksionet gjyqësore dhe udhëheqjen e departamenteve.

Çdo tre mujor dhe sipas nevojës, kryetar i gjykatës ka mbajtur takime të veçanta me gjyqtarët e Departamentit për Krime të Rënda, Divisionit Penal, Divisionit Civil dhe Divisionit për Kundërvajtje.

Në muajin dhjetor 2022, është mbajtur mbledhja e kolegjiumit të të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës Themelore në Ferizaj dhe degëve ne Kaçanik dhe Shtërpcë, ku është diskutuar lidhur me rezultatet e punës së gjykatës për vitin 2022, në veçanti janë diskutuar edhe raportet statistikore për secilin gjyqtar. Janë dhënë edhe propozime për zgjidhjen efikase të lëndëve për secilin departament. Në kuadër të këtij takimi është diskutuar edhe për planin e punës së gjykatës për vitin 2023, i cili pas kësaj është aprovuar dhe i njëjtë i është dërguar Këshillit Gjyqësor për aprovim. Në kuadër të planit të punës është edhe Programi për Zgjidhjen Efikase të Lëndëve, i cili program ngërthen në vete priorititetet dhe rekomandimet për secilin departament dhe divizion në përgjithësi.

### ***Administrata***

Personeli i gjykatës është menaxhuar mbi bazën e parimeve të profesionalizmit, paanshmërisë, integritetit, transparencës, qëndrueshmërisë, shërbimit për publikun, meritës dhe vazhdimesisë në karrierë, përgjegjësisë dhe korrektësisë në zbatimin e legjisacionit në fuqi, të cilat garantojnë shërbime efektive. Planifikim të duhur për rekrutim të stafit, i cili është dhe do të rekrutohet mbi bazën e meritave profesionale, në një proces të drejt dhe plotësisht transparentë.

### ***Transparenca, informimi i publikut***

Publiku ka qenë i informuar rregullisht mbi punën dhe veprimtarinë e gjykatës, përmes portalit gjyqësor e po ashtu edhe rrjeteve social, si me orarin e seancave, njoftimet e ndryshme ashtu edhe me vendimet gjyqësore, të cilat i kanë mundësuar publikut qasje më e lehtë në punën e gjykatës.

Të gjitha aktgjykimet janë publikuar në portalin e gjykatës, siç përcaktohet edhe me Udhëzimin Administrativ për Anonimizimin dhe Publikimin e Aktgjykimeve, dhe deri më sot në ueb janë të publikuara gjithsejtë janë publikuar afër pesë mijë (10569) aktgjykime të anonimizuara, ndërsa vetëm në vitin 2022 janë publikuar 2922 aktgjykime të anonimizuara.

Bashkëpunimi i ngushtë USAID në pilot projektin Drejtësia Procedurale, i cili projekt ka për qëllim zbatimin e iniciativës për Drejtësi Procedurale, dhe tani është në fazën e përgatitjes së planit të veprimit për përmirësimin e drejtësisë procedurale për palët në Gjykatë dhe përmirësimin e shërbimeve të Gjykatës për një përvojë funksionale dhe mikpritëse në gjykatë, si dhe për të zgjeruar aftësinë e punonjësve në këtë gjykatë për tu përfaruar me komunitetin.

Gjykata Themelore në Ferizaj ka vazhduar me implementimin e Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (TIK/SMIL), i cili ka treguar sukses dhe rritjen e efikasitetit dhe transparencës së gjykatës. Stafi i gjykatës, duke përfshirë edhe gjyqtarët janë trajnuar. Gjatë vitit 2021 raportet individuale të gjyqtarëve dhe raportet e përgjithshme të gjykatës, janë nxjerr vetëm përmes sistemit SMIL (edhe pse në secilin takim me gjyqtarët e kësaj gjykate janë ngritur shqetësime lidhur me pasqyrat e raporteve nga sistemi i SMIL në raport me lëndët fizike që i kanë në zyrë). Të gjitha kërkesat dhe aktakuzat e prokurorisë së shtetit pranohen përmes SMIL, përjashtuar kërkesat konfidenciale (UGJK), po ashtu orari i seancave gjyqësore për publikim në ueb faqen e gjyqësorit është i lidhur direkt me SMIL, ndërsa me qëllim të digjitalizimit të punës së gjykatës dhe bazuar edhe në vendimin e KGJK-së, shumica e regjistrave manual janë larguar nga përdorimi.

## PËRFUNDIMI

Si përfundim vlerësojmë se viti 2022, ka qenë periudhë me një ngritje të vogël në aspektin e ngritjes së efikasitetit të përfundimit të lëndëve, të dhënat tregojnë një ngritje të shkallës së normës së spastrimit të çështjeve gjyqësore sa i përket Gjykatës Themelore në Ferizaj, mirëpo ardhja e një numri të madhe të lëndëve civile që kanë të bëjnë me kontratat kolektive (arsim, shëndetësi dhe polici), gjithashtu edhe bojkoti i punës së gjyqtarëve në fund të vitit ka ndikuare në uljen e përqindjes në shkallë të përgjithshme të punës së kësaj gjykate.

